



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA CËRRIK

Data: 26.04.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “*Rehabilitim i kanalit Shtepanje-Shushice ne Nj.a Gostime dhe kanali Mollas, Nj.A Mollas*”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi për kanale ujëtare 45247111-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 27784300 (*njzetë e shtatë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e kater mijë e treqind*) Lek pa TVSH.

Perlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”, Inxhinieri është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar ne ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia CERRIK** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

Argumentimi:Ky kriter u vendos me mbështetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit / kualifikimit (shtojca 7)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% se fondit te vene ne dispozicion).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Ne lidhje me situaten ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojme qe operatoret ekonomike kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar per te zbatuar kontraten”, ”Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar ne nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Duke marrë në konsideratë numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloj shërbimesh, sasinë dhe cilësinë e shërbimit objekt procedure prokurimi, afatin e kontrates dhe eksperiencat e mëparshme nga AK Bashkia Cerrik dhe Autoritete të tjera kontraktore kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë ne kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qellim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin

deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2021,2022,2023), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit si dhe të jenë me vlerë dhe të shoqëruara me Akt - Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm kur janë në kushtet e ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke pasur parasysh që lloji i procedurës është “e hapur”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.3 Vërtetimi të shlyerjes së taksave e tarifave vendore për vitin 2023 dhe të vitit 2024 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar), në të gjitha adresat ku operatorët ekonomikë kanë ushtruar aktivitetin e tyre sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKB-së. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

2.3.1 Pune te ngjashme :

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim, anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në këtë bashkim.

Në rastin kur operatorët ekonomikë anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtem:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike:
 - Kontratë sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar
 - Aktin e kolaudimit(*në rastet kur ky dokumentacion lëshohet*)
 - Çertifikaten e marrjes në dorëzim/ Çertifikatën e përkohshme të marrjes në dorëzim
 - Faturat tatimore
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës Nr. 9

Shënim:Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

Shënim:Me termin pune te ngjashme do te konsiderohen ato punime te ngjashme te realizuara ne:

i) kanale vaditese, vepra kullimi e vaditje;

Argumentimi i mesiperm eshte i bazuar ne aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi ku specifikohet se nje subjekt licensohet me pikat e licences profesionale sipas puneve te ngjashme te realizuara gjate viteve te fundit.

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat:
 - Kontrate sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar
 - Aktin e kolaudimit(*në rastet kur ky dokumentacion lëshohet*)
 - Vërtetim lëshuar nga subjekti privat, për kryerjen me sukses të kontratës
 - Faturat tatimore

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë përveç dokumentacionit të mësipërm, edhe:

- *Kontratën e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit*

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë përveç dokumentacionit të mësipërm, edhe:

- *Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve të objektit që prokurohet, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjise, ne baze të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- NP-1 A Punime gjurmimi në tokë.
- NP - 5 A Punime nëntokësore, ura e vepra arti.
- NP - 6 A Diga dhe tunele hidroteknike.
- NP- 7 B Ujesjelles, gazsjelles, vajsjelles, vepra kullimi e vaditje
- NP – 8 A Ndertime detare dhe punime thellimi në uje.
- NP-12 B Punime të inxhinierise së mjedisit.

Për punimet speciale të ndërtimit:

- N.S- 9 A Punime strukturore speciale.
- N.S-18 A Punime topogjeodezike.

Ne rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zerave të preventivit dhe përqindjes që në baze të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsiper të realizojë.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjise, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 8 përcakton “Zbatimi I punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, private ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
NP-1	Punime gjurmimi në tokë.	<i>Sipas preventivit Zeri 1/1 , I/7, II/1, 3/1 etj</i>	A	0-20 milion
NP - 5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti.	<i>Sipas preventivit</i>	A	21-50 milion
NP - 6	Diga dhe tunele hidroteknike	<i>Sipas preventivit</i>	A	0-20 milion
NP- 7	Ujesjelles,gazsjelles, vajsjelles, vepra kullimi e vaditje	<i>Sipas preventivit Objekti është rehabilitim kanale vadites cka e ben te domosdoshme kerkesen per kete license</i>	B	21-50 milion
NP – 8	Ndertime detare dhe punime thellimi ne uje.	<i>Sipas preventivit</i>	A	0-20 milion
NP-12	Punime te inxhinierise se mjedisit.	<i>Sipas preventivit</i>	B	21-50 milion
N.S- 9	Punime strukturore speciale.	<i>Sipas preventivit</i>	A	0-20 milion
N.S-18	Punime topogjeodezike	<i>Sipas preventivit</i>	A	0-20milion

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, **Drejtues Teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë :

- Inxhinier Ndërtimi 1 (nje)
- Inxhinier Topograf 1 (nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- Inxhinier Gjeolog 1 (nje)
- Inxhinier Mjedisit 1 (nje)
- Inxhinier Mekanik 1 (nje)

Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin drejtues teknik** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi - Profili Gjeoteknik 1 (nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
 - Kontratat e punës individuale, (të vlefshme).
 - Diplomën përkatëse.

- Deklaratë nga Administratori ku të përcaktohet se Drejtuesi Teknik i mësipërm nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.
- Te gjithë punojësit e mësipërm duhet të figurojnë në listepagesat të shoqërisë minimalisht për periudhën Janar 2024 - Mars 2024.
- Një nga Drejtuesit e mësipërm ose një punonjës i Operatorit Ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM-se Nr. 312, dt 05.05.2010 "Për sigurinë në kantier", VKM-së Nr.108, dt 09.02.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1.a dhe 1.b, i cili duhet të figurojë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.
- Nese operatori ekonomik ofertues nuk disponon nje punonjes me kualifikimin e kerkuar me siper mund të paraqesë një kontratë me persona apo subjekte të cilët kryejnë shërbime të specializuara në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, jashtë ndërmarrjes, e cila duhet të ketë kohëzgjatje për të mbuluar të gjithë periudhën e ofrimit të shërbimeve që janë objekt i këtij prokurimi.

Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të paraqesë 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë".

Mos paraqitja e këtij informacioni do konsiderohet si kusht për skualifikim. Autoriteti Kontraktor do të verifikojë saktësinë e informacionit. Mos dorëzimi i informacionit të saktë apo të rremë do të konsiderohet kusht për skualifikim dhe/ose fillim i hetimit administrativ për perjashtim të Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 26 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", pika 6 "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese",

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin Teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor Teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin Teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në Kreun IV të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", pika 1 "Drejtuesi teknik i shoqërisë", gërma b) parashikohet: "Licenca profesionale e

shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimin të komisionit për dokumentacionin e paraqitur. Përcaktimi i kërkesës për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objektin e garantuar autoritetin jo vetëm për angazhimin tere kohë e kryerjes së punimeve të një drejtuesi teknik të shoqërisë por dhe si orientim për një person kontakti dhe urë lidhëse mes mbikqyresit të punimeve dhe AK për problematiken që do të haset gjatë realizimit të punimeve. **Kërkesa për certifikate për "sigurinë dhe shëndetin në punë"** është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikqyrjes.

Inxhinier Ndërtimi - inxhinieri i ndërtimit është i nevojshëm për të ndjekur të gjitha punimet për ndërtimin e kanaleve.

Inxhinier Topograf - është përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit objekt prokurimi.

Inxhinier Hidroteknik- është përgjegjës për zbatimin e projektit për kanalet të cilat do të rehabilitohen.

Inxhinier Gjeolog- është i nevojshëm pasi në preventivin fillestar paraqiten zëra konkrete.

Inxhinier Mjedisi - Kërkohet inxhinier mjedisi pasi kemi të bëjmë me punime germimi, ndërtimi, heqje dherash etj, që kanë ndikim negativ në mjedisin përreth. Gjatë zbatimit të projektit, është e pashmangshme që në realizimin e punimeve të ketë mbeturina e inerte të cilat janë të një rrezikshmërie të lartë për komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet të realizohet në përpikmëri dhe në kohë reale, prandaj asistencë e një inxhinieri mjedisi do të jetë e domosdoshme.

Inxhinier Mekanik - E kemi kërkuar këtë inxhinier për arsye se mund të ketë problematika gjatë zbatimit të punimeve dhe mund të ketë ndryshime dhe rregullime të cilave mund t'i përgjigjet gjatë zbatimit inxhinieri përkatës. Si dhe është e domosdoshme asistencë e inxhinierit për çdo defekt të mundshëm të mjeteve që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë:

Punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit të punimeve, si më poshtë:

Nr	<i>Punonjës të specializuar/të kualifikuar</i>	Numri i kërkuar
1	Teknik Ndërtimi	- 1 (nje)
2	Teknik Topograf	- 1 (nje)
3	Teknik Mekanik	- 1 (nje)
4	Murator	- 3 (tre)
5	Karpiertier	- 3 (tre)
6	Hekurkthyes	- 2 (pese)

7	Betonues	-	4 (kater)
8	Saldator	-	2 (dy)
9	Hidraulik	-	4 (kater)
10	Pergatites te konstruksioneve metalike	-	1 (nje)
11	Montator	-	1 (nje)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr.Amzes ose Deshmise	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
etj					

Per punonjesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Te gjithë punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë ne listepagesat të shoqërisë minimalisht per periudhen Janar 2024 - Mars 2024.
- Per Teknikun e Ndertimit, teknikun topograf, teknikun mekanik duhet te paraqitet diplome / deftese e shkolles se mesme.
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i kualifikimit per diplomën/certifikaten përkatëse si dhe emrin e institucionit qe ka lëshuar dokumentin per specialistet e kualifikuar me siper.

Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar** për kryerjen e punimeve si më poshtë :

- Manovrator/ ekskavatorist 4 (kater)
- Automakinist 4 (kater)
- Buldozerist 1 (nje)
- Shofer kamioni me kategori mimimalisht C 4 (kater)
- Shofer kamiocine me kategori mimimalisht B 2 (dy)

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- (Dëshmi te Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënie e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtime dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor (të vlefshme).
- Te gjithë punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë ne listepagesat të shoqërisë minimalishtper periudhen Janar 2024 - Mars 2024.
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit shofer, manovrator, automakinist dhe buldozeriste, emer/mbiemer, profil i punes, numri dhe daten e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale.

- I. **20 punetore** te thjeshte ndërtimi, per te cilët te paraqitet kontratat e punës si dhe te figurojnë ne listepagese minimalisht Janar 2024 - Mars 2024.

Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

- **Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”,**

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Punonjesit e mesiperm jane te domosdoshem per:

Teknik Ndërtimi- eshte i domosdoshem per te ndjekur te gjitha punimet e ndertimit e perkatesisht ne zerat : I/3 ,

Teknik Topograf – eshte i domosdoshem per ndekjen e e punimeve ne preventivin fillestar.

Teknik Mekanik –eshte i domosdoshem per ndjekjen e punimeve dhe ne rast te defektit te mjeteve te jete I disponueshem per rregullimin e tyre apo cdo problem tjeter qe do te shfaqet ne fazen e punimeve.

Murator – eshte I domosdoshem per te kryer punimet e betonit per ngritjen e murit ne zerat 3, , 6 etj

Karpentier – eshte I domosdoshem per kryerjen e punimeve ne preventivin fillestar e perkatesisht ne zerat ne an. 8 zerat 3, 4, ne an.7 zeri 3,4. etj

Hekurkthyes - eshte I domosdoshem per kryerjen e punimeve ne preventivin fillestar e perkatesisht ne zerat e an. 5 zeri , an 7 zeri 6, an 8 zeri 6 etj

Betonues –eshte I domosdoshem per kryerjen e punimeve ne preventivin fillestar e perkatesisht ne ne zerat e an.4 zeri 6, an.5 zeri5,6 ,an.6 zeri 5etj.

Saldator – eshte il domosdoshem per kryerjen e punimeve te saldimit e perkatesisht ne An.9 zeri3, an.6 zeri3, An.4 zeri 4 etj.

Hidraulik –eshte i domosdoshem per kryerjen e punimeve hidraulike e perkatesisht ne zerat an.2 zeri 1

Pergatites te konstruksioneve metalike – eshte I domosdoshem per kryerjen e punimeve ne zerat e an. A2/1

Montator – eshte i domosdoshem per kryerjen e punimeve ne zerat e An. 2

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim jo me pak se **55 (pesedhjetë e pese)** punonjes me kohe te plote ne fushen e ndertimit, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën Janar 2024 - Mars 2024 e vërtetuar me:

- Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2024 - Mars 2024.
Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per 3 (tre) muajit e fundit te deklaruar, ku te percaktohet numri I punonjesve per cdo muaj.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”,

Argumentim: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimi. Autoriteti

kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përllogaritje të saktë të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” Në këtë kontekst, autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve për objektin e prokurimit, orëve të punës (8 ore ne dite për cdo punonjës) afatit kohor të realizimit të kontratës si dhe shpërndarjes së punës. Në numrin e përcaktuar për fuqinë punëtore janë përllogaritur stafi teknik dhe inxhinierik si dhe stafi administrativ. Nga përllogaritja e orëve të punës për cdo zë pune rezulton se për kryerjen e punimeve sipas grafikut të punimeve duhen 60 punonjës.

Per punimet qe do te kryhen per kete objekt jane kryer perlllogaritjet si me poshte:
39611.26 ore pune /90 dite afati I levrimit /8ore ne dite = 55 punonjes.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2024 - Mars 2024, ose duhet të paraqitet një kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të licencuar, sipas ligjit. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht në përputhje me numrin respektiv të punonjësve sipas kërkesave ligjore.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në bazë të VKM nr.692, dt.13.12.2001, “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë” i ndryshuar me VKM Nr. 742, dt.06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë”

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Makineri dhe pajisje	Nr.	Njesia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-14 ton	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Kamion vetëshkarkues me kapacitet jo me të vogël 20 ton	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtës 1.5 deri në 3.5 ton	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me zinxhir	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me goma me targa (mjet teknologjik)	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Miniekskavator	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Fadrom me kove para dhe krahe mbrapa/skrep me targa (mjet teknologjik)	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Bobkat/ minifadrome	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Autovinc me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Autobetoniere	3	cope	Ne pronesi ose me qera
Autobot uji	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Buldozer S-80/100 KF	2	cope	Ne pronesi ose me qera
RTV - Transportier për mjete të rënda mbi 15 ton peshë mbajtëse (për përdorim të vecant)	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Moto gjenerator ≤50 kv	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Damper kantieri	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Vibrues betoni	4	cope	Ne pronesi ose me qera
Cekic për prishje betoni	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Tranxhe hekuri/kthyesë hekuri	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Gjenerator	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Karoca dore	8	cope	Ne pronesi ose me qera

Matrapik	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Trapano	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Elektrosaldatrice	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Gazogjen	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Kontenjer (zyre)	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Nivelues betoni	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Armaturë/betoforma/lendë drusore	2000	M2	Ne pronesi ose me qera
Kokore	100	cope	Ne pronesi ose me qera
Jelek	100	cope	Ne pronesi ose me qera
GPS	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Total station	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Tabela sinjalizuese kantieri	5	cope	Ne pronesi ose me qera
Komplet i ndihmes se shpejte	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Impiant prodhim betoni me QKL	1	cope	Në pronësi, me qera, osekcontratëfurnizimi

a) Për mjetet në pronësi, që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Police sigurimi (e vlefshme)
4. Leje transporti (leshuar nga pushteti vendor e vlefshmeose D.P.SH.T.RR)

b) Licence per transport mallrash per te trete dhe me qira brenda vendit (e vlefshme).

c) Për mjetet e marra me qera, që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse qirasë (e vlefshme).
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
4. Police sigurimi (e vlefshme)
5. Leje transporti per vete dhe te tretee vlefshme (leshuar nga pushteti vendor ose D.P.SH.T.RR)

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten e verifikimit te saktësisese informacionit. Mos dorëzimi i informacionit të saktë apo të rremë do te konsiderohet kusht për skualifikim dhe/ose fillim i hetimit administrativ për perjashtim të Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”,

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës.

2.3.8 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë **EN-ISO 9001:2015** (e vlefshme) ose ekuivalente/barasvlefshme, Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën EN-ISO 9001:2015).
- Certifikatë **EN ISO 45001: 2018** mbi “*Shëndetin dhe sigurimin në punë*”, ose ekuivalente/barasvlefshme, Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën EN ISO 45001: 2018)
- Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit **ENISO 14001-2015**(e vlefshme) ose ekuivalente/barasvlefshme, Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën **EN ISO 14001-2015**).

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kërkesa për keto certifikata është bere pasi janë të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 9001:2015 - Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte të cilësisë, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës.

ISO 45001: 2018 – Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

ISO 14001-2015- Eshtë standarti më i përdorur në botë për sistemet e menaxhimit të mjedisit. Rikonstruksioni I objektit konkret, përveçse kërkojnë një kapacitet me makineri kanë edhe një ndikim në mjedis për shkak të kushteve në të cilat realizohen si ndotja e ajrit nga pluhurat e kantierit ndotja akustike dhe mjedisore nga makinerite etj, aq me teper qe kemi te bejme me dy objekte brenda ne qytet. Për këtë arsye cdo operator ekonomik duhet të jetë i çertifikuar për menaxhimin e ambientit. Eshtë në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

2.3.9 Operatori Ekonomik të ketë Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III. 2. B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve te ngurta, inerte”. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor të mbetjeve te ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqipërisë”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25, se bashku me aktin e miratimit ku minimalisht te perfshihen kodet 17 05 04 dhe 17 09 04.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, VKM nr.538 datë 26.05.2009 “Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuara, “Veprimtaria e nënkategorisë. Kriteri per licencen e leshuar nga QKL me kodin III. 2. B eshte vendosur qe AK te kete sigurine qe operatori ekonomik qe do te ofertoje te jete i pajisur me certifikatat e mesiperme ose te kete kontrate sherbimi me subjekte te licencuara me licencen e lartepemendur, te lidhura me objektin e prokurimit, gje e cila krijon bindjen dhe sigurine te Autoriteti Kontraktor qe ky Operator Ekonomik i zoteron kapacitetet teknike per realizimin me sukses te kontrates.

Në seksionin “Kategoria III.2. “Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.2.B”, pika 8 dhe 9 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar parashikohet se: “ Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. 9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.”.Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, ku të përfshihen ndër të tjera edhe transporti i mbetjeve të ngrurta, gjatë kryerjes së veprimtarisë ose te kene kete kontrate sherbimi noteriale per objektin konkret me shoqeri te licensuara si me siper.

Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.” Sa më sipër konstatohet se gjatë kryerjes së punimeve, referuar edhe parashikimeve të preventivit, shfaqet ndër të tjera kryerja e veprimtarisë transporti i mbejteve inerte i cili referuar kuadrin ligjor në fuqi duhet te kryhet nga subjekte te licensuara dhe është në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. Kerkesa per te paraqitur akt miratimin eshte bere per te verifikuar nese mbetjet qe do te largohen jane te percaktuara ne licencen e subjektit per tu administruar dhe transportuar.

2.3.10 Operatori ekonomik ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates te publikuar ne DST, duhet të paraqesë autorizim/kontrate/marreveshje bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë si më poshtë:

- a) Hekur
- b) TUB Celiku

Në rast paraqitjeje te autorizimit nga Distributori duhet te paraqitet dokumentacioni qe verteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar.

Argumentim: Kjo kerkese eshte bazuar ne nenin 40 pika 6/c te VKM-se nr.285 date 19.05.2021 ” Per miratimin e Rregullave te prokurimit Publik dhe VKM nr. 679, date 22.10.2004 "Per miratimin e rregullave teknike per perdorimin e betoneve strukturore",

2.3.11 Operatorët ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale më një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN 12390-7:2019, SSH EN 12350-2:2009, SSH EN 12504-2:2012, SSH EN ISO 6892 – 1:2019, SSH EN 12390-8:2019.

Argumentim: Kjo kerkese eshte bere ne perputhje me nenin 44/1 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: „Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.3.12 Grafiku i punimeve sipas te gjitha zerave te preventivit dhe afateve te parashikuara nga Autoriteti Kontraktor.**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”,**

2.3.13 Vetëdeklarim, sipas deklaratës në vijim, ku të evidentohen objektet dhe vlerat përkatëse të kontratave, nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “*periudhë*” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCES

(Për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Specifikimet teknike janë hartuar nga inxhinier i licensuar dhe do të bashkëngjiten dokumentave të tenderit në SPE.

NJESIA E PROKURIMIT
